

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k**

*I. THEMELIMI*

**NENI 1  
Ortaket themelues**

Shoqeria krijohet nga ortaku themelues:

**-Z. Alfred Pjetri**, shtetas shqiptar, lindur më 09.05.1981 në Kaçinar, identifikuar me leternjoftim, me nr personal I10609150U, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI*

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqeria emertohet “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqerite Tregtare”.

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqeria “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: *TIRANE Njesia Administrative Nr. 9, Rruga "Reshit Petrela", Kompleksi Usluga, Hyrja 3, Kati 2, Hyrja 1, Njesia Tregtare Nr. 7.*

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojnë nen mbikqyrjen e Administratorëve të “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k.

**NENI 5  
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë "ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2" Sh.p.k, do të ketë për objekt: "Projektim, zhvillim software, PLC, sisteme skada dhe telekomunikacioni. Projektim instalim dhe venien ne pune te sistemeve te kontrollit lokal dhe ne distance per hidrocentrale, nenstacione elektike dhe impiante teknologjike. Konsulence teknike dhe mirembajtja e tyre, programimin e automatizimeve per kontrollin e proceseve. Konsulence ne fushen e energjitikes dhe burimeve te rinovueshme. Menaxhimin e impianteve per prodhimin e energjise nga burime te rinovueshme, ndermjetesim per investime ne sektorin energjistik dhe mekanik. Trajnime per mirembajtjen e impianteve energjitike. Projektim, furnizim vendosje hidrocentrale me fuqi deri 40MW per agregat, supervizionimin e punimeve per llogari te klientit nga furnizuesit e paisjeve, kryerjen e testeve te agregateve dhe pranimin e tyre per operim.

Stacione per matje meteorologjike dhe hidrologjike, furnizimin kalibrimin dhe mirembajtjen e tyre ne kohe. Sisteme matje prurje per kanale te hapura apo ne tubacione.

Import, eksport, projektme dhe zbatime ne fushen e inxhinierise elektrike. Tregtim te artikujve te ndryshem industrial. Planifikimi, zhvillimi, ndertimi, operimi dhe mirembajtja, per vete dhe per te tretet te impianteve te energjise se rinovueshme, centraleve ne baze te burimeve te ripertertitshme te energjise, te tilla si era, uji, biomasa, rrezatimi diellor dhe burimet potenciale te tjera te energjise.

Tregtim, prodhim, montim dhe mirembajtje te moduleve fotovoltaike si dhe konstruksionet mbajtese te tyre.

Supervizim, projektim, zbatim dhe matje te sistemeve te tokezimit per nensctacione elektrike dhe impiante te ndryshme industriale.

Realizimin e matjeve periodike te rezistencës së izolimit, rezistencës së kontaktit, të provave të vajit elektrik të transformatorëve të fuqisë, rezistencës ohmike të pështjellave si dhe testimin e mbrojtjes rele për prodhuesit e energjisë dhe impianteve të ndryshme elektrike.

Marrje në përdorim, me qera, koncesione apo forma të tjera, toka, objekte apo vepra të ndryshme nga subjekte private apo publike.

Projektim në fushën e ndërtimit, infrastrukturës, urbanistikës, mekanikës, ujësjellësave, gazsjellësave dhe veprave të artit.

Punime gërmimi, ndërtimi, rikonstruksione dhe mirëmbajtje në objekte civile dhe industriale., impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, nënstacioneve elektrike, kabinat e transformatorëve, linjat e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarje të energjisë elektrike, automatizim/informatizim i proceseve civile dhe industriale, impiante CCTV.

Studime fizibiliteti në fushën e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë. Tregtim, riparim i pajisjeve elektrike, mekanike, elektronike për përdorim industrial për vinça, elektrovinça portual, etj."

5.3 Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Asamblesë, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në baze të vendimit të Asamblese se Pergjithshme.

### III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

#### **NENI 6 Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### **NENI 7 Kapitali i Shoqerise**

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere 1000 (një mijë) leke dhe nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- **Z.Alfred Pjetri**, shtetas shqiptar, lindur më 09.05.1981 në Kaçinar, identifikuar me leternjoftim, me nr personal I10609150U, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, zoteron 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 1000 (njemije) leke, qe perben 100 % (njëqind përqind ) te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **NENI 8 Asambleja e Pergjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti i’a rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise “ELEKTRONIKA INDUSTRIALE 2” Sh.p.k.

8.2 Mbledhja e Asamblese se ortakeve mund te zhvillohet edhe ne distance nepermjet lidhjes audiovizive, kur kjo gje eshte shprehur ne njoftimin e thirrjes me shkrese apo postes elektronike.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme jane te vlefshme edhe ne rastet kur ato merren me pelqimin e ortakeve nepermjet lidhjes audiovizive.

8.3 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

#### **NENI 9 Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqerisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqerisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

## NENI 10

### Administratori i Shoqërisë

- 10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.  
10.2 Administratori është të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin “ Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Statutin, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.  
10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qendrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetesh me të drejtë ripërtëritje.  
10.4 Administratori i parë i shoqërisë emerohet:

- **Z.Alfred Pjetri**, shtetas shqiptar, lindur më 09.05.1981 në Kaçinar, identifikuar me leternjoftim, me nr personal I10609150U, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit



- 11.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

## NENI 11


### Ligji i zbatueshëm dhe mosmarreveshjet

- 12.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, referencë i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.  
12.2. Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.  
12.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortakët themelues.

### ORTAKU THEMELUES

**Z.Alfred PJETRI**



Tiranë, më 14.06.2021